

## STATUT

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR Root92 SH.P.K.

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, dhe të Aktit të Themelimit të Shoqërisë **Root92 SHPK** ("Shoqëria"), veprimtaria e saj do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti:

#### Neni 1

##### Emërtimi

- 1.1 Emërtimi i Shoqërisë është **Root92 SHPK** ndjekur pandashmërisht nga prapashtesa SHPK, e cila përfaqëson formën ligjore të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.
- 1.2 **Root92 SHPK** do të ketë shenjat e veta dalluese dhe vulën e saj, e cila miratohet nga Ortakët e Shoqërisë.

#### Neni 2

##### Forma ligjore

- 2.1 Shoqëria është një person juridik shqiptar, e cila ka formën juridike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, dhe e zhvillon veprimtarinë e vet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, dhe Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.

#### Neni 3

##### Objekti

- 3.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:

Konsulence informatike. Krijime dhe zhvillime software.

- 3.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet në përputhje me dispozitat ligjore, të zbatueshme me vendim të ortakëve të saj / Asamblesë së Ortakëve.

#### Neni 4

##### Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.
- 4.2 Vendosija e mëpasshme e një kufizimi në kohë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

#### Neni 5

##### Selia

- 5.1 Selia e shoqërisë tregtare "Root92" SHPK do të jetë në adresën: Tirane, Tirane Njesia administrative nr 10 . rr. Kavajes , Ndertesa nr 116 , Ish qendra Gurten Tirane 1001
- 5.2 Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë këtij territori, duke hapur zyra apo degë ose nëpërmjet veprimtarive të kryera në përputhje me misionin dhe statutin e Shoqërisë, si dhe legjislacionin në fuqi.

#### Neni 6

### **Kapitali themeltar**

- 6.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është në vlerën 200.000 Lekë e përbërë nga 1 kuote.
- 6.2 Ortakët e shoqërisë janë:  
Z. **Gabriel Manolache**, shtetas Rumun, lindur më 04.07.1992, i cili zotëron një kuotë të kapitalit themeltar të shoqërisë me vlerë nominale 200.000 Lekë (dyqindmije leke).

### **Neni 7**

#### **Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit**

- 7.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me Vendim të Ortakëve të Shoqërisë / Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme me Ortakëve

### **Neni 8**

#### **Transferimi i pjesëve të kapitalit**

- 8.1 Kuota e kapitalit të Shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej saj mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar më ligj.
- 8.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët.
- 8.3 Miratimi për transferimin e kuotës bëhet nga me Vendim Ortakut të vetëm të Shoqërisë / Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve

### **Neni 9**

#### **Organi vendimmarrës**

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme me Ortakët është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë (në vazhdim Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve).
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të Statutit në përputhje me dispozitat ligjore.
- 9.3 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
  - b) ndryshimet e Statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorit/ve;
  - d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesit/ve dhe të ekspertit/ëve kontabël;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën “c” e “d” të pikës 9.3 të Statutit;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - gj) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
  - h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - i) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - j) riorganizimin, falimentimin, likuidimin dhe prishjen e Shoqërisë;
  - k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
  - l) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti dhe të cilat nuk janë kompetencë e administratorit/ëve.
- 9.4 Çdo ndryshim Statuti duhet të depozitohet në QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.
- 9.5 Të drejtat e Asamblesë së Përgjithshme do të ushtrohen nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë, për sa kohë që kapitali themeltar do të zotërohet vetëm nga një ortak.

## **Neni 10**

### **Kuorumi**

- 10.1 Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortakët e Shoqërisë ose të autorizuarit e tyre të posaçëm.

## **Neni 11**

### **Administrimi**

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme emëron 1 (një) Administrator të Shoqërisë. Afati i emërimit, është 3 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
- 11.2 Administratori i vetëm i Shoqërisë, do të jetë:  
Znj. **Syndi Lasdushaj**, shtetas shqiptar, lindur në Lac më 08.11.2003, banues Lac.
- 11.3 Administratori ka të gjitha kompetencat si një organ ekzekutiv i shoqërisë për të vepruar në marrëdhënie më të tretët në emër të Shoqërisë, në të gjitha rrethanat e lejuara nga statuti dhe ligji i zbatueshëm.

## **Neni 12**

### **Përgjegjësitë e Administratorit**

- 12.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit "Për Tregtarët e Shoqëritë Tregtare" Administratori detyrohet:
- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në Statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë veprimtarisë së Shoqërisë në mjedisin tregtar dhe përkatës;
  - të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në Statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të Shoqërisë;
  - të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm, siç kërkohet në dispozitat ligjore të zbatueshme.
  - të sigurojë zbatimin e legjislacionit në fuqi për shoqëritë.

## **Neni 13**

### **Viti Financiar**

- 13.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon në 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor të vitit përkatës.

## **Neni 14**

### **Kontrolli Financiar**

- 14.1 Shoqëria mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të autorizuar për kryerjen e kontrollit financiar të veprimtarisë së saj.

## **Neni 15**

### **Prishja e Shoqërisë**

- 15.1 Prishja e Shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:
- me vendim të Ortakëve të Asamblesë së Përgjithshme;
  - me mbylljen e procedurave të falimentimit apo likuidimit vullnetar;
  - nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar (apo legjislacioni i zbatueshëm).

- me vendim të gjykatës.

- 15.2 Ortakët / Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyrën e prishjes së Shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidues dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".
- 15.3 Prishja e Shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e paaftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët / Asambleja e Përgjithshme të Ortakëve.
- 15.4 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas Vendimit të Ortakëve / Asamblesë së Përgjithshme për prishjen e Shoqërisë, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 16**

##### **Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi ndarja**

- 16.1 Shoqëria mund të ndahet dhe bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe në këtë Statut.

#### **Neni 17**

##### **Dividenti**

- 17.1 Shoqëria do t'i shpërndajë Ortakëve të saj dividendin vjetor që mund të mbeten pasi të ketë përmbushur të gjitha kërkesat kontraktore dhe detyrimet ligjore, dhe detyrimet për mbajtjen e rezervave të domosdoshme dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe pasi të jetë ndarë fondi për investim kapital nëse Ortakët / Asambleja e Përgjithshme do të vendosë për një të tillë.

#### **Neni 18**

##### **Mosmarrëveshjet**

- 18.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti dhe funksionimin e Shoqërisë, palët i drejtohen legjisllacionit shqiptar dhe synojnë zgjidhjen me mirëkuptim. Në rast të kundërt për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Statut hartohet në 2 (dy) ekzemplarë origjinalë në gjuhën shqipe.

#### **ORTAKËT E SHOQËRISË**

**Gabriel Manolache**

